REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1942/1 Prot. Tiranë, më 29 . 10 .2026

V E N D I M

Nr. 290 , Datë 29 . 10 . 2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 272, datë 22.10.2026, të z. R. Sh kundër Ujësjellës Kanalizime sha, Pogradec, në të cilën pretendohet për diskriminim për *"çdo shkak tjetër*[1]*"*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Subjekti ankues, z. R. Sh është banor i qytetit të Pogradecit. Ankuesi citon se, mes tij dhe ish-Ujësjellës Kanalizime sha Pogradec është lidhur kontrata e furnizimit me ujë, e cila mban numrin 60792. Si titullar i kësaj kontrate, ankuesi shprehet se ka shlyer gjithmonë të gjitha detyrimet financiare që rridhnin nga ekzekutimi i saj. Në muajin dhjetor 2013 ankuesit i është komunikuar një faturë, e cila përmban për likuidim vlerën prej 5 050 628.96 lekësh.

Ankuesi pretendon se, fatura sipërcituar është hartuar në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008, të ndryshuar, duke mos pasqyruar vlerën e konsumit real së bashku me çmimin. Fatura në fjalë, sipas ankuesit, nuk plotëson asnjë element ligjor dhe formal sipas pikës 4, të nenit 40, të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008, të ndryshuar, ku citohet se: *"Faturat e paraqitura konsumatorit duhet t'i japin atij mundësinë për të verifikuar me përpikëmëri llogaritjen e shitjes ose shërbimit të siguruar në një periudhë të caktuar"*.

[1] Duke cituar faturimin e parregullt dhe cenim të të drejtave të konsumatorit.

Ankuesi ka depozituar në cilësi prove pagesat e kryera rregullisht prej tij si abonent duke evidentuar se në asnjë faturë nuk figuron detyrim i prapambetur në vlerën prej 5 050 628.96 lekësh.

Z. Sh shprehet se nga e Ujësjellës Kanalizime sha Pogradec, i është sqaruar fakti se, vlera që del si detyrim është për shkak të një problemi në sistemin e faturimit të UK Pogradec. Ankuesi ngre shqetësimin se, qenia e këtij detyrimi e kufizon atë në të drejtat për ushtrimin e transaksioneve, pasi nuk mund të pajiset nga ana e kësaj Shoqërie me një vërtetim që nuk ka detyrime. Për rrjedhojë, në kushtet kur ai figuron debitor për një shumë e cila nuk ka të bëjë me konsumin e ujit të pijshëm, por rezulton si debi mbi të si konsumator, lidhur me një faturë të plotësuar në kundërshtim me ligjin, ka kërkuar nga ana e Shoqërisë heqjen e këtij detyrimi.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi *verifikimin e ligjshmërisë dhe saktësisë së faturës së muajit dhjetor 2013, anullimin e detyrimit prej 5 050 628.96 lekësh, si dhe korrigjimin e të dhënave financiare përkatëse.*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për një listë joshteruese shkaqesh. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."*

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD, të ndryshuar, përcaktohet se: *""Diskriminim" është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi".*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesja pranë KMD-së, konstatohet se:

Z. R. Sh është banor i qytetit të Pogradecit. Ankuesi është titullar i kontratës me nr. 60792, lidhur mes tij si abonent dhe Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sha Pogradec, si ofrues shërbimesh. Në muajin dhjetor 2013 ankuesit i është komunikuar një faturë, e cila përmban për likuidim vlerën prej 5050 628.96 lekësh.

Sipas pretendimeve në ankesë, z. Sh figuron debitor për një shumë e cila nuk ka të bëjë me konsumin e ujit të pijshëm, por rezulton si debi mbi të si konsumator, lidhur me një faturë të plotësuar në kundërshtim me ligjin. Ai ka kërkuar nga ana e Shoqërisë heqjen e këtij detyrimi.

Sa më sipër, Komisioneri vëren se:

Së pari, referuar parashtrimeve të ankuesit, rezulton se ai ka marrë dijeni për diskriminimin e pretenduar dhe pasojat e tij që në muajin dhjetor 2013, kur i është komunikuar fatura nga ana e Shoqërisë UK Pogradec. *(citojmë deklarimin e ankuesit: Në muajin dhjetor' 2013 më është sjellë një faturë, e cila përmban për likuidim vlerën prej 5 050 628.96 lekësh)*
Duke qenë se data e depozitimit të ankesës nr. 272 Regj., pranë KMD-së është 22.10.2026, rezulton se nga momenti i marrjes dijeni per sjelljen diskriminuese te pretenduar (2013) e deri në datën e paraqitjes së ankesës kanë kaluar më shumë se 12 (dymbëdhjetë) vjet.

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, i cili parashikon se: *"Ankesa nuk pranohet kur: .... (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese"*, Komisioneri gjykon se ankesa është paraqitur në tejkalim të afatit ligjor të parashikuar në LMD. Afatet e parashikuara në këtë dispozitë janë alternative dhe jo kumulative; për mospranimin e ankesës mjafton plotësimi i njërit prej tyre.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ankesa është paraqitur tej afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, për paraqitjen e ankesave pranë Komisionerit. Për rrjedhojë, ankesa nuk mund të pranohet për shqyrtim nga Komisioneri[2].

Së dyti, pavarësisht faktit se, dhe vetëm qenia e ankesës jashtë afateve ligjore të parashikuara në LMD, konsiderohet element i mjaftueshëm për mospranimin e saj për shqyrtim, Komisioneri evidenton gjithashtu, mungesën e një shkaku të mbrojtur nga LMD-ja, si dhe mungesën e kompetencës për pretendimin për verifikimin e ligjshmërisë dhe saktësisë së faturës së muajit dhjetor 2013, anullimin e detyrimit prej 5 050 628.96 lekësh, si dhe korrigjimin e të dhënave financiare përkatëse, sipas argumentit të mëposhtëm:

[2] Për analogji shih vendimet nr. 64, datë 27.04.2023, nr. 139, datë 26.07.2023, nr. 161, datë 09.06.2026, të Komisionerit.

Nga përmbajtja e ankesës rezulton se subjekti ankues nuk ka individualizuar dhe konkretizuar një shkak diskriminues të mbrojtur nga neni 1 i ligjit nr. 10221/2010, i cili të ketë shërbyer si bazë për trajtimin e pretenduar të pafavorshëm.

Në kuptim të nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010, diskriminimi nuk konsiston në çdo trajtim të padrejtë, çdo shkelje ligjore apo çdo konflikt të krijuar ndërmjet një individi dhe një autoriteti publik. Për të qenë i tillë, dallimi, përjashtimi, kufizimi ose preferenca duhet të jetë i bazuar në një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1 të ligjit dhe të ketë si qëllim ose pasojë pengimin apo bërjen të pamundur të ushtrimit të një të drejte ose lirie në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

Në rastin konkret, ankuesi i referohet në mënyrë të përgjithshme "çdo shkaku tjetër", pa identifikuar një karakteristikë, status ose rrethanë personale të mbrojtur nga ligji. Pretendimi se është diskriminuar nga ana e Shoqërisë UK Pogradec, për "çdo shkak tjetër", duke sqaruar tek ky shkak *faturimin e parregullt dhe cenimin e të drejtave të tij si konsumator,* nuk përbën, në vetvete, një shkak diskriminues të mbrojtur nga LMD-ja. Cenimi i të drejtave të tij është pasojë e mbifaturimit sipas pretendimit të ankuesit dhe jo shkaku në vetvete.

Sipas nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 *"*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, i cili citon se: *"Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar…",* ankesa nuk mund të pranohet dhe nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj[3].

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç/dh, të LMD-së, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pretendimi i ankuesit për mbifaturim të faturës së ujit nga ana e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sha Pogradec, dhe kërkesa e tij për *verifikimin e ligjshmërisë dhe saktësisë së faturës së muajit dhjetor 2013, anullimin e detyrimit prej 5 050 628.96 lekësh, si dhe korrigjimin e të dhënave financiare përkatëse,* është një pretendim lidhur me paligjshmërisë e kryer nga ana e Shoqërisë, që në thelb lidhet me kundërshtimin e faturës për "Pavlefshmëri të titullit ekzekutiv" (bazuar në nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile), pretendim i cili është jashtë sferës së veprimit dhe kompetencës lëndore të KMD-së, sa kohë nuk lidhet me diskriminimin. Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se, sa i takon këtij pretendimi, ankuesi mund të kërkojë *gjyqësisht* deklarimin e pavlefshëm të faturës.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4/ç/dh, të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

[3] Shih Vendimet: nr. 127, datë 28.05.2026, dhe nr. 143, datë 28.05.2026, nr. 170, datë 16.06.2026, të KMD-së.

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga z. R. Sh, kundër Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sha Pogradec, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)